



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planimi Doretuzat Planimes Prodato Kecneset Dobvity	28.09	2022	2	viti god year
Organ Njesta Organ Jedindra Org Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSACK	5735	2022	1/8	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.701/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.701/2022 të datës 12.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Lagja kundër Vendimit me numër KA.Nr.24/2022 të datës 14.07.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.701/2022 e datës 12.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.24/2022 i datës 14.07.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezultoi se Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 15.11.2021 ka shpallur Konkursin Nr.Ref KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ-021 për pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Shkrimore* në Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Konkursi ka qenë i hapur nga data 15.11.2021 deri me datë 29.11.2021 i vazhduar deri me datë 09.12.2021, ndërsa interesim konkurrimi ka shprehur gjashtë (6) kandidatë duke përfshirë edhe ankuesin. Në listën e ngushtë të datës 15.12.2021 si kandidatë që kanë plotësuar kushtet formale të konkursit janë përzgjedhur pesë (5) aplikues përfshirë edhe ankuesin i cili i është nënshtruar me tej të gjitha fazave të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit me shkrim me datë 20.12.2021 dhe intervistës me gojë me datë 23.12.2021. Bazuar në Njoftimin për Përzgjedhje të përfundimtare të datës 29.12.2021 të

Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të SKPK-së, kandidati [redacted] është shpallur si kandidati më i suksesshëm me gjithsej 70.7 pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me njoftimin përfundimtar, me datë 29.12.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së. Ky i fundit me Vendimin me numër KA.Nr.09/2022 të datës 15.02.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 29.12.2021 për zgjedhjen e kandidatit të suksesshëm.

Ankuesi kundër Vendimit KA.Nr.09/2022 të datës 15.02.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të Rregullores Nr.02/2010 për Pranimin në Shërbimin Civil, favorizimin e kandidatit të përzgjedhur si dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.236/2022 të datës 28.04.2022 ka aprovuar ankesën e datës 16.03.2022 të ankuesit duke e anuluar Vendimin KA.Nr.9/2022 të datës 15.02.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, njoftimin përfundimtar të datës 29.12.2021, testimin të kandidatëve dhe lista e ngushtë e datës 15.12.2021 lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, e shpallur sipas konkursit Nr.Ref:KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ-021 të datës 15.11.2021 si dhe duke obliguar Drejtorin e Përgjithshme të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës që brenda afatit prej pesëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu që procedura e rekrutimit si në pikën II të dispozitivit të vazhdoj nga përgatitja e listës së ngushtë.

Në bazë të provave të lëndës, autoriteti punëdhënës në pajtim me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka vazhduar procedurën e rekrutimit për pozitën e lartcekur, Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, më datë 17.05.2022 ka përgatitur listën e shkurtër prej katër (4) kandidatëve, ku ankuesi nuk është përfshirë në listën e shkurtër, ndërsa ankuesi më datë 18.05.2022 ka kërkuar nga znj. B.Luzha se përse nuk është përfshirë në listën e shkurtër, ndërsa ankuesi përmes emailit të datës 20.05.2022 është njoftuar që Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil punën e tij e ka kryer në bazë të legjislacionit në fuqi, ndërsa nëse e konsideroni që të është shkelur ndonjë e drejtë mund të shfrytëzoni të drejtën e ankesës.

Pas përfundimit të vlerësimit të listës së shkurtër, testimin me shkrim dhe testimin me gojë, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 01.06.2022 ka publikuar njoftimin për përzgjedhje përfundimtare të kandidatit. Ankuesi kundër këtij njoftimi më datë 29.06.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ky i fundit me Vendimin me numër KA.Nr.24/2022 të datës 14.07.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 01.06.2022 për zgjedhjen e kandidatit të suksesshëm.

Ankuesi kundër Vendimit KA.Nr.24/2022 të datës 14.07.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës brenda afatit ligjor më datë 12.08.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:4679/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të Rregullores

Nr.02/2010 për Pranimin në Shërbimin Civil, favorizimin e kandidatit të përzgjedhur si dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale dhe përbërja e komisionit me kryetaren e cila ka qenë e suspenduar në një periudhë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa më datë 23.08.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Vendimit VK.nr.101/2022 të datës 22.09.2022 ka vazhduar afatin për vendimmarrje për dhjetë (10) ditë pune lidhur me ankesën e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Port:4679/2022 Ankesë e paraqitur në Sekretariatit e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nr.4679/2022 të datës 12.08.2022; Ekskluzive: Suspendohet administratorja e Prokurorisë në Gjakovë e publikuar në Sinjal.com të datës 21.04.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë nr.4766/2022 të datës 16.08.2022; Përgjigje në ankesë nga Këshilli Prokurorial nr.1424/2022 i protokolluar në SKPMSHCK me nr.4915/2022 të datës 23.08.2022; Vendimi i Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës K.A. Nr,24/2022 të datës 14.07.2022; Ankesë e paraqitur në Këshillin Prokurorial të Kosovës e protokolluar me numër 1110 të datës 29.06.2022; Procesverbali i Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës së datës 01.07.2022; Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nr.2500/2022 të datës 28.04.2022; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës së datës 01.06.2022; Rekomandim për emërim nga Udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore të datës 26.05.2022; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues Form.MAP-SHCK-11 të datës 25.05.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve Form.MAP-SHCK-10; Vlerësimi individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj Form.MAP-SHCK-08a 25.05.2022 për Form.MAP-SHCK-10; Vlerësimi individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj Form.MAP-SHCK-08a 25.05.2022 për Form.MAP-SHCK-10; Vlerësimi individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj Form.MAP-SHCK-08a të datës 25.05.2022, për Përmbledhja e vlerësimeve individuale e intervistës të datës 25.05.2022; Formulari i vlerësimit individual në intervistën e gojë të datës 25.05.2022 ; Formulari i vlerësimit individual në intervistën e gojë të datës 25.05.2022 ; Formulari i vlerësimit individual në intervistën e gojë të datës 25.05.2022 ; Formulari i vlerësimit individual në intervistën e gojë të datës 25.05.2022; Regjistri i njoftimit për ardhje në intervistë; Lista përfundimtare e përzgjedhjes të testit me shkrim të datës 23.05.2022; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e testit me shkrim të datës 23.05.2022; Lista me vlerësimin e kandidatëve; Raport lidhur me listën e ngushtë për pozitën- Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores/Prokuroria Themelore Gjakovë të datës 17.05.2022; Regjistri i njoftimit për ardhje në testim me shkrim; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim Form.MAP-SHCK-07a të datës 15.11.2021; Shkresë të datës 17.05.2022 lidhur me listën e kandidatëve për vendin e punës -

Udhëheqësi i Sektorit të Shkrimore; Lista përfundimtare e përzgjedhjes së listës së ngushtë të datës 17.05.2022; Përmbledhja e vlerësimeve individuale të listës së ngushtë të datës 17.05.2022; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë të datës 17.05.2022; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë të datës 17.05.2022; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë të datës 17.05.2022; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë të datës 17.05.2022; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë të datës 17.05.2022; Shkresë elektronike të datës 23.05.2022 nga [redacted] Shkresë elektronike të datës 23.05.2022 nga [redacted] Shkresë elektronike të datës 16.05.2022 nga [redacted] Kërkesë nga ankuesi të datës 19.05.2022; Kërkesë nga NKUESI të datës 18.05.2022; Përgjigje në kërkesë të datës 20.05.2022 nga [redacted] Njoftim nga [redacted] të datës 19.05.2022; Njoftim nga [redacted] të datës 13.05.2022; Njoftimi nga Divizioni i Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës së datës 13.05.2022; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesave të datës 17.05.2022 në anëtarëet e KPSHC-së; Vendimi i U.D. të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës DPSKPK 432/2021 të datës 14.01.2021; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë të datës 15.11.2021; Konkursi i shpallur në gazetën ditore "Epoka e Re" 15.11.2021; Konkursi i shpallur në gazetën ditore "Epoka e Re" 01.12.2021; Konkursi i rishpallur nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës në gjuhën serbe; Vazhdimi i konkursit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Konkursi i rishpallur nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës në gjuhën shqipe; Vazhdimi i konkursit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës në gjuhën serbe; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit të datës 25.05.2022 nga [redacted] Testi me shkrim të datës 20.05.2022 nga [redacted] Testi me shkrim të datës 20.05.2022 nga [redacted] Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit të datës 25.05.2022 nga [redacted] Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit të datës 26.11.2021; Aplikacioni për punësim nga [redacted] të datës 22.11.2021; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë të datës 22.11.2021; Vërtetim punësimi të datës 30.01.2018; Vërtetim për performancën e punës të datës 29.01.2018; Marrëveshje punësimi në gjuhën angleze të datës 29.12.2017; Marrëveshje punësimi në gjuhën angleze të datës 10.05.2017; Marrëveshje punësimi në gjuhën angleze të datës 27.04.2016; Marrëveshje punësimi në gjuhën angleze të datës 28.01.2016; Marrëveshje punësimi në gjuhën angleze të datës 23.01.2015; Vërtetim i lëshuar nga organizata për demokraci "Qohu" të datës 18.09.2020; Kontrata e punës së datës 01.10.2018; Aneks kontratë 1 të datës 01.02.2019; Certifikatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr.03//790 të datës 25.03.2015; Formular për vlerësimin e rezultateve të punës së datës 16.02.2015; Akt emërim me numër Ref.03-31 të datës 18.02.2014; Certifikatën e lëshuar nga Fakulteti Juridik për [redacted] Certifikatën e lëshuar nga Qendra Trajnuese për avokatë të datës 26.02.2017; Certifikatën e lëshuar nga USAID-i /shkurt 2018; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" nr.522 të datës 01.10.2013; Diplomë e lëshuar nga Fakulteti Juridik nr. 1393 të datës 06.04.2012; Certifikatën në gjuhën angleze të datës 20.03.2008; Certifikatën nga Ambasada Norvegjeze/KCSF të vitit 2019; Certifikatën nga organizata për Demokraci "Qohu" e lëshuar për [redacted] Certifikatën e lëshuar nga Bashkësia Evropiane për [redacted] në fushën { Të drejtat mjedisore të njeriut); Referencë të datës 21.10.2014; Rekomandim të datës 18.11.2014; Referencë të datës 18.11.2014; Referencë të datës 17.11.2014 Referencë të datës 21.10.2014; Vërtetim i lëshuar nga HENDIKOS të datës 30.01.2014; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit nr.1586 të datës 02.12.2021; Aplikacioni për punësim të datës 30.11.2021; Ndryshim dhe plotësim i aktit të emërimit 01/112/02-16391 të datës 07.07.2017; Certifikatën të datës 16.12.2014; Certifikatën për [redacted] e lëshuar nga SEED të datës 21-23. Dhjetor 2015; Certifikatën e lëshuar nga [redacted]

Instituti i Kosovës për Administratë Publike të datës 28-29-shtator 2018; Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike të datës 28-29 shtator 2015; Vërtetimi i marrëdhënies së punës i lëshuar nga Komuna e Gjakovës Nr.112/316/2021 të datës 25.11.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë të datës 28.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë të datës 28.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 27.12.2019; Certifikatën për [] e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Ref.03-16/98 të datës 02.06.2016; Vendimi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës Nr. 112/02- 2021; Certifikatën për [] e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike të datës 15-16- shtator 2016; Certifikatën për D. Bakija e lëshuar nga GIZ - Mars 2018; shtetësie të datës 28.02.2011; Certifikatën e shtetësie të datës 28.02.2011; Vërtetimi nga DPH "Roma"-Gjakovë të datës 07.01.2014; Vërtetimi nga "Nesim Bakija/Gjakovë të datës 04.01.2010; Certifikatën nr. 207/2008 të datës 07.07.2009; Certifikatën nr.273/2008 të datës 07.07.2009; Njoftim për kandidatin e suksesshëm me Nr. Prot. 01/111/01-3693 të datës 30.06.2017; Rekomandimi i datës 28.09.2018; Vërtetimi i datës 01.04.2011; Vërtetimi nr.01/2013 të datës 13.12.2013; Certifikatën të datës 23.07.2009; Diplomë nr. 1121 të datës 03.06.2016; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit nr.1583 të datës 01.12.2021; Aplikacioni i datës 26.11.2021; Diplomë nr.1008/15 të datës 13.08.2015; Akt emërim të datës 01.03.2018, Nr. Prot. DBNJ/DSKPK/525/2018; Akt emërim të datës 01.02.2014 me Nr. Prot. ZBNJ/DP-473/2014; Kontratë pune nr. 473/2015/PTH-GJA të datës 20.10.2015; Kontratë e punësimit nr.13/GJA-PPK të datës 30.11.2009; Certifikatën Nr. 633/2021 të datës 22.06.2021; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit nr.1574 të datës 25.11.2021; Aplikacion për punësim të datës 25.11.2021; Diplomë e lëshuar nga Kolegji Iliria nr.397/12 të datës 07.01.2013; Vërtetimi nr. 112266/2018 të datës 24.10.2018; Certifikatën me Nr. 10933/2021 të datës 22.11.2021; Vërtetim të datës 22.10.2021; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit nr.1588 të datës 03.12.2021; Aplikacioni për punësim nr.1588 të datës 02.12.2021; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës nr. 436 të datës 30.12.2008; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës nr.409 të datës 16.04.2013; Certifikatën Nr. 34/2016 të datës 15.04.2016; Akt emërim të datës 04.07.2019; Vërtetim nr. DBNJ230/2021 të datës 23.11.2021; Formulari për vlerësimin e punës provuese 04.07.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 20.12.2019; Referencë të datës 07.04.2017; Referencë e lëshuar nga USAID të datës së datës 14.11.2012; Certifikatën me Nr.120/2010 të datës 30.03.2010; Certifikatën e OSBE-së të datës shkurt 2007; Certifikatën të datës 19.01.2011; Certifikatën të datës 22.04.2011; Certifikatën të datës 30-31. Korrik 2018 Certifikatën të datës 04.04.2011; Kontratë mbi praktikën në punë të datës 05.07.2010; Certifikatën me Nr.57/2010 të datës 18.02.2010; Certifikatën me Nr.190/2010 të datës 20.05.2010;Diplomë të datës 18.03.2003; Certifikatën të datës 08.05.2007; Certifikatën të datës 12.04.2021; Referencë Apr.nr. 114/2021 të datës 23.11.2021; Certifikatën me Nr. 10853/2021 të datës 18.11.2021; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit Nr.1571 të datës 23.11.2021; Aplikacion për punësim të datës 23.11.2021; Diplomë nr.821 të datës 25.02.2010; Diplomë të datës 06.12.2019; Akt emërim të datës 15.07.2013; Akt emërim të datës 14.07.2014; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës prej datës 01.01.2018-31.12.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës prej datës 01.01.2019-31.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.12.2020; Akt emërim ref. 03/112-102 të datës 09.11.2012; Kontratë për shërbime të datës në kohëzgjatje prej 22.12.2010- 20.02.2011; Kontratë për shërbime të datës në kohëzgjatje prej 22.02.2011- 20.04.2011; Kontratë për shërbime të datës në kohëzgjatje prej 20.04.2011- 24.06.2011; Kontratë për shërbime të datës në kohëzgjatje prej 27.06.2011- 26.08.2011; Kontratë për shërbime të datës në kohëzgjatje prej 05.09.2011- 05.11.2011;

Diplomë nr prot. 658 të datës 25.05.2002. Formulari i regjistrimit të ankesës të datës 12.08.2022; Vendimin VK.nr.101/2022 të datës 22.09.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit [redacted] **SEPSE:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që në rastin konkret për këtë procedurë të rekrutimit konkretisht për pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores* në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, ka pasur favorizim për kandidatin e suksesshëm, ka pasur diskriminim ndaj meje në këtë proces si dhe kryetarja e komisionit ka qenë e suspenduar për një konkurs paraprak ndërsa ka marr pjesë në këtë proces.

Fillimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ju referua Aktgjykimit me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë ka gjetur se Gjykata Kushtetuese në pikën III të aktgjykimit ka konstatuar se: Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me: *Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokuroria të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë. Andaj, në kuptim të këtij aktgjykimi Kolegji vlerëson se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në raport me Këshillin Prokurorial zbatohet Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.*

Sipas Konkursit Ref.KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ-021, për pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores* në Prokurorinë Themelore në Gjakovë si kriteret themelore janë përcaktuar: *Diplomë e Fakultetit Juridik ose Administratë Publike; dhe minimumi katër (4) vite përvojë pune profesionale.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se ka pasur favorizim për kandidatin e suksesshëm Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ka shqyrtuar tërë procedurën e rekrutimit për këtë pozitë dhe në bazë të provave materiale, ka konstatuar se në bazë të Njoftimit për përzgjedhje përfundimtare të datës 01.06.2022 kandidati [redacted] pas testit me shkrim dhe testit me gojë ka marrë gjithsejtë 69.5 pikë, rrjedhimisht Kolegji, pas shqyrtimit të formularit për përmbledhjen e vlerësimeve individuale në testin me gojë kanë marr pjesë dy kandidatë me gjithsejtë 69.5 pikë dhe [redacted] me 61.6 pikë, kështu që gjatë analizimit të testit me shkrim dhe me gojë nuk është vërejtur ndonjë favorizim për kandidatin e suksesshëm sepse, në shërbimin civil emërohen kandidatë që kanë numrin më të madh të pikëve siç parashihet me dispozitat e nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin e ankuesit se ka pasur diskriminim ndaj meje në këtë proces, ka konstatuar që në bazë të provave të lëndës ankuesi nuk është përfshirë në listën e shkurtër për faktin që nuk ka plotësuar kushtet e konkursit respektivisht përvojën e punës pas diplomimit, për faktin që i njëjti sipas Diplomës 1008/2015 të datës 13.08.2015 ka përfunduar studimet themelore universitare me datë 24.06.2015 në programin Juridik të Përgjithshëm, ndërsa lidhur me përvojën e punës sipas Kontratës së Punës Nr.13/GJA-PPK ka punuar si Zyrtar i Sigurimit nga data 30.11.2009 deri 29.11.2012 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, Sipas Kontratës së Punës pa afat Nr.473/2015/PTH-GJ ka punuar si Vozitës nga data 20.10.2015 në Prokurorinë Themelore në Gjakova, ndërsa sipas Akt Emërimit DBJ/DSPK/525/2018 të datës 01.03.2018 ankuesi me datë 01.03.2018 është emëruar dhe ushtron pozitën Referent i Lartë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Andaj nisur nga të gjeturat si më lart ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës respektivisht i njëjti deri në mbylljen e konkursit më datë 09.12.2021 nuk ka pasur 4 vjet përvojë pune profesionale pas diplomimit ngase vetëm puna Referent i Lartë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë njihet si përvojë e punës profesionale, e mbi këtë bazë rezulton se Komisioni Përzgjedhës me përfshirjen e ankuesit në listë të ngushtë pa plotësimin e kriterëve të pozitës së shpallur, ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: arsimimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës, shkathhtësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera të meritë*, kështu që lidhur me përvojën e punës pasi diplomimit Kolegji i është referuar Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit AA.nr.367/1819.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përmes këtyre vendimeve gjyqësore konstatohet fakti se për pozita profesionale përvoja e punës duhet të jetë pas diplomimit, andaj në rastin konkret të ankuesit nuk ka pasur asnjë lloj diskriminimi, kështu që edhe pretendimet e tij janë të pabazuara në këtë aspekt.

Sa i përket pretendimet ankimor të ankuesit se kryetarja e komisionit ka qenë e suspenduar për një konkurs paraprak ndërsa ka marr pjesë në këtë proces, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që sipas emailit të Burimeve Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës e njëjta ka pranuar vendimin nga Komisioni Disiplinor me date 07.04.2022 për suspendimin e saj në afat prej 1 muaji dhe me pas e njëjta ka filluar punën me date 15.05.2022, në këtë rast të njëjtës me asnjë dispozitë ligjore nuk i ndalohet pjesëmarrja në Komisionin Përzgjedhës të Shërbimit Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga vlerësimi i tërësishëm i procedurës së rekrutimit për *Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores* në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, konstaton se procedura e rekrutimit është zhvilluar konform legjislacionit në fuqi, duke marr parasysh që edhe njoftimin për kandidatin e suksesshëm është shpallur në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që kjo procedurë është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paaftësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* dhe Rregullores

Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si rrjedhje pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.Nr.24/2022 i datës 14.07.2022, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Kështu që, pas konstatimit të të gjeturave si me lartë si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.701/2022, datë 28/09/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së